



BASHKIA  
TIRANË



**Drejtuar:** Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "Dajti Park 2007" shpk & "Agri Konstruksion" shpk

**Adresa:** Tirane, Dajt Lagjja Qesarake, Godine banimi dhe sherbimesh 3,4 kate +nenkati+2 kate bodrum, Kati 1

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit e zgjedhur në bazë të Nenit 30 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu IV, Neni 33 është "**Procedurë e Hapur**".

Përshkrim i shkurtër i kontratës "**Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar "Ymer Lala", Surrel**", sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

**Nr. Ref. 89323-10-10-2018**

Fondi limit: **45.832.598** ( dyzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind nëntëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 132, datë 21.12.2017, për "Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 12.11.2018 ora: 11.00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 41** datë **15.10.2018**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "ELDA-VL" shpk me nr. NUIS K67106202E  
**Vlera e ofertës pa TVSH =0 ( zero) lekë**

2.Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Dajti Park 2007" shpk & "Agri

Konstruksion” shpk, me nr. NUIS K11507003S &K01725001F

Vlera e ofertës pa TVSH **44.339.123** (dyzet e kater milion e treqind e tridhjetë e nente mije e njeqind e njezet e tre) **lekë**.

### **3.Operatori Ekonomik “Leon Konstruksion” shpk, me nr. NUIS K71820009I**

Vlera e ofertës pa TVSH, **41.248.682,4** (dyzet e nje milion e dyqind e dyzet e kater mije e gjashteqind e tetedhjetë e dy presje kater) **lekë**.

#### **4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Lala ” shpk & “Jody”shpk me nr. NUIS J76418903B & J94824803M**

Vlera e ofertës pa TVSH, **41.322.790** ( dyzet e nje milion e treqind e njezet e dy mije e shtateqind e nentedhjetë) **lekë**

#### **5. Operatori Ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk,me nr. NUIS K71401004E**

Vlera e ofertës pa TVSH, **43.584.433** ( dyzet e tre milion e peseqind e tetedhjetë e kater mije e katerqind e tridhjetë e tre) **lekë**

#### **6. Operatori ekonomik “GPA Konstruksion ” shpk, me nr NUIS K71423001Q**

Vlera e ofertës pa TVSH Vlera e ofertës pa TVSH **0** ( zero) **lekë**

#### **7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Vllaznia Ndërtim” shpk “Ndregjoni” shpk, me nr. NUIS K77524909Q & K31329048I**

Vlera e ofertës pa TVSH **37.992.449** (tridhjetë e shtate milion e nenteqind e nentedhjetë e dy mije e katerqind e dyzet e nente) **lekë**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

#### **1- Oferta e Operatorit Ekonomik “Leon Konstruksion” shpk**

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik “Leon Konstruksion” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti teknik (shtojca 10), të Dokumentave Standarte të Tenderit

Së pari AK, në dokumentat e Standarte teTenderit ka kërkuar si më poshtë cituar:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 10).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona me kapacitet mbajtës minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur një kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit

Gjithashtu AK ka kërkuar ti vihet në dispozicion një fadromë me goma për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë fadromë me dokumentacionin e duhur të përcaktuar në Dokumentat Standarte të tenderit.

Operatori ekonomik ka paraqitur një Fadromë me goma AA904JA i siguruar me qera me anë të kontratës me nr 3062 rep dhe nr.906 kol me afat deri më datën 24.10.2019. Autoriteti Kontraktor në përmbushjen e kriterit të deklarimit të mjeteve ka kërkuar paraqitjen e dokumentave si në rastin kur mjetet janë në pronësi dhe në rastin kur mjetet janë siguruar nëpërmjet qerasë dhe në rastin kur mjetet janë siguruar nëpërmjet qerasë operatori ekonomik duhet të sigurohet që afati i qerasë të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e **e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.** Afati i

realizimit të objektit të këtij prokurimi është 12 (dymbëdhjetë) muaj, sa më sipër kontratat e qerasë e mësipërme është e pavlefshme .

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton të kërkuar nga AK (4 copë) si dhe me mjetin fadromë me goma (1 copë), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së dyti AK ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti teknik, pika 5, si më poshtë cituar:

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe në listpagesat e shoqërisë për gjashtë muajt, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë:

Arkitekt (1)

Inxhinier Ndertimi (1)

Inxhinier Mjedisi (1) Inxhinier Mekanik(1)

Inxhinier Topograf (1)

**Inxhinier Elektrik. (1)**

Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur si inxhinier elektrik Zonjën me iniciale L.D nga verifikimi që iu bë dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në sistemin elektronik të app-së rezultoi që Zonja L. D. nuk rezulton në listpagesat e shoqërisë për muajt : Prill , Maj, Qershor, Korrik, Gusht dhe Shtator të vitit 2018.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik I mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik .

Pra sa më sipër cituar, dokumentacioni i paraqitur nga Operatori ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 5 është i paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë**, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **2- Oferta e Bashkimit te Operatorëve Ekonomik “Ndregjoni” shpk & “Vllaznia” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi I Operatoreve “Ndregjoni” shpk & “Vllaznia” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik (shtojca 10), të Dokumentave Standarte të Tenderit

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë ( shtojca 10).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës.

Bashkimi I Operatorëve Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur dy kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 7 ton dhe maximum 12 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës.

Bashkimi I Operatorëve Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur tre kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte të Tenderit

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton të kërkuar nga AK (4 copë) si dhe me kamionat me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton dhe maksimumi 12 ton të kërkuar nga AK (4 copë) për rrjedhojë i pavlefshëm.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion një eskavator me goma. Bashkimi I Operatorëve Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur mjetet eskavator me goma me targë AC MT 80 dhe Eskavator me goma me targa AC MT 81, të cilët rezultojnë të angazhuar në procedurë tjetër ku operatori është shpallur fitues, për rrjedhojë nuk do të konsiderohet i saktë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamioncina me kapacitet deri në 2 ton

Bashkimi I Operatorëve Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur Kamionçinë me targa AA153PS e cila rezultojnë të angazhuar në procedurë tjetër ku operatori është shpallur fitues, për rrjedhojë nuk do të konsiderohet i saktë.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet, përvojën e duhur, personelin dhe kapacitetet e duhura ekonomike e financiare, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi dhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Bashkimi I Operatorëve ekonomik duhej të dorëzonte në sistemin e prokurimeve elektronike të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor si edhe në përputhje dhe sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik për mënyrën e hedhjes së dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **3- Oferta e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Lala ” shpk & “Jody”shpk**

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Lala ” shpk & “Jody”shpk , nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik, pika 9 .

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 9 si më poshtë cituar:

Operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë në staf të punësuar si më poshtë si dhe të rezultojnë në listpagesat e shqërisë për të paktën tre muajt e fundit:

a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) **(i pajisur me “Certifikate për auditimin e energjise)**

(Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise)

b. ekspert zjarrfikes te certifikuar (1 person)

**(Për ekspertin zjarrfikës certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit )**

Operatori ekonomik “Lala” shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur si auditues energjie Znj. E.SH për të cilën ka paraqitur një certifikatë ku citohet se ka frekuentuar kurs për auditues energjie por ju bëjmë me dije se autoriteti kontraktor ka kërkuar Certifikatë (DIP) për eficientën në energji.

Për sa më sipër BOE nuk ka paraqitur 1 punonjës auditues energjie sipas formatit të kërkuar.

Operatori ekonomik “Lala” shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur si ekspert zjarrfikës Z. A.G për të cilin nuk ka paraqitur asnjë certifikatë me anë të së cilës të përmbushet kriteri I kërkuar nga AK në dokumentat e tenderit .

Për sa më sipër BOE, nuk ka paraqitur 1 punonjës ekspert zjarrfikës sipas formatit të kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër BOE “Lala” shpk dhe “Jody” shpk nuk zotërojnë kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.*

**Gjithashtu, Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:**

*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda ng ate cilet **dy automakiniste dhe dy eskavatoriste**. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.*

Bashkimi I operatoreve ekonomike te mesiperem kanë paraqitur në përmbushje të këtij kriteri si më poshtë:

N.L manovrator manovrator / drejtues automjeti per te cilin nuk ka paraqitur deshmi drejtimi e cila të tregojë kujt kategorie I përket eskavatorist apo automakinist te vlefshme

Sh.A manovrator manovrator / drejtues automjeti per te cilin nuk ka paraqitur deshmi drejtimi e cila të tregojë kujt kategorie I përket eskavatorist apo automakinist te vlefshme

L.Q manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

R.G manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

A.L manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

K.A manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

G.Q manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi I Operatorëve Ekonomikë të mësipërm është i paplotë, pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur punonjësit manovrator/ automakinist të kërkuar nga AK;

Pra sa më sipër Bashkimi i Shoqërive “Lala” shpk dhe “Jody” shpk nuk zotëron kapacitet të

mjaftueshem teknik për sa i përket *personelit të nevojshëm* për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e **shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### 4. Oferta e Operatorit Ekonomik “Kevin Konstruksion ” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik si më poshtë cituar:

##### ***Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;***

Nga verifikimi në sistemin elektronik të APP-së mbi dokumentat e paraqitur nga operatori ekonomik I mësipërm rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur shtojcën 10 si dhe mjetet e kërkuara nga AK.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 2.3, si më poshtë cituar:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 22.916.299 (njëzet e dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit të llogaritura nga data e zhvillimit të tenderit.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit të llogaritura nga data e zhvillimit të tenderit, është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **91.665.196** (nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**

Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues, në përmbushje të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 2.3

AK ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pika 5, si më poshtë cituar:

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe në listpagesat e shoqërisë për gjashtë muajt, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë:

Arkitekt (1)

Inxhinier Ndertimi (1)

Inxhinier Mjedisi (1) Inxhinier Mekanik(1)

Inxhinier Topograf (1)

Inxhinier Elektrik. (1)

## **Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të vërtetë përmbushjen e kriterit të mësipër**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **5. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “ELDA-VL” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “GPA Konstruksion” shpk**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “GPA Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “GPA Konstruksion” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.11.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ”Dajti Park 2007” shpk & “Agri Konstruksion” shpk, me nr. NIPTI K11507003S & K01725001F** me adresë: **Tirane, Dajt Lagjja Qesarake, Godine banimi dhe sherbimesh 3,4 kate +nenkati+2 kate bodrum, Kati 1** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **44.339.123** (dyzet e katër million e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzetë e tre) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do ju konfiskohet sigurimi i ofertës( nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006, (i ndryshuar).